




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-0/DPK	Nr. Prot. Prot. No 01-3011/13
Nr. f.faq. Broj strana 02	Datim Datum 26-09-2013



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 16.09.2013, nxjerr këtë :

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK- 03-236/13,për,z. Ilhami Gashi, Sekretar i përgjithshëm ne Ministrin e Punëve të Brendshme, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, pasi qe zyrtari ne fjalë nuk ushtron me funksion publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm te interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.2 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës se marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-236/13 qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Ilhami Gashi, sekretar i përgjithshëm ne Ministrin e Punëve te Brendshme , ku është dyshuar për konflikt të mundshëm te interesit ne ushtrimin e Funksionit Publik si, sekretar i përgjithshëm ne Ministrin e Punëve te Brendshme , dhe angazhimit të tij ne veprimtari tjera private si pronarë dhe person i autorizuar ne biznesin private me emër NT "Elko-IG".

Pas analizimit te gjendjes është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, pasi qe z. Gashi, nuk është me duke e ushtruar poziten e sekretarit te përgjithshëm ne Ministrin e Punëve te Brendshme, dhe nuk e ka me statusin e zyrtarit te lartë publik sipas ligjit ne fuqi, ky fakt

dëshmon se nuk kemi gjendje te konfliktit te Interesit dhe nuk kemi situata qe dëshmon se ka shkelje te Ligjit për Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne ushtrim e funksionit publik . Andaj duke vlerësuar gjëndjen faktike konstatojmë se nuk ka elemente qe dëshmojnë gjëndjen e Konfliktit të Interesit, pasi qe z.Ilhami Gashi, nuk ushtron funksion publik dhe nuk e ka statusin e zyrtarit të lartë .

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

